



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 50

Qershor

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.157, datë 15.3.2006	Për miratimin e planit të veprimit të reformës rregullatore, në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit	3
Vendim i KM nr.158, datë 15.3.2006	Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të rrugëve të përdorë procedurat e prokurimit të Bankës Botërore, për hartimin e projektit të detajuar të rrugës Rrëshen- Kalimash	26
Vendim i KM nr.162, datë 21.3.2006	Për caktimin e anëtarëve, përfaqësues të Këshillit të Ministrave, në Këshillin Mbikëqyrës të Agjencisë së Trajtimit të Kredive ...	26
Vendim i KM nr.163, datë 21.3.2006	Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit të “Ish-spitalit të KFOR-it”, Durrës, nga Ministria e Shëndetësisë te Ministria e Drejtësisë, për sistemimin dhe akomodimin e kontingjentit të të sëmurëve me mjekim të detyruar, me vendim gjykate	27
Vendim i KM nr.168, datë 29.3.2006	Për njohjen dhe pagesën e detyrimit financiar investitorit italian “Immobiliare Toscana, di Baldini Giuseppe&C”, S.n.c., ortak në ish-ndërmarrjen e përbashkët “Alb-it, Agro Adriatik”, Hamallaj, Durrës	29
Vendim i KM nr.182, datë 21.3.2006	Për ngritjen e Komisionit të Ndihmës Shtetërore	30
Vendim i KM nr.196, datë 5.4.2006	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin e znj. Rushem Golemi në Itali	31
Vendim i KM nr.203, datë 5.4.2006	Për ndryshimin dhe kalimin e përgjegjësisë së administrimit të objekteve reparti, komanda, palestra dhe poligoni, të repartit Renea, Tiranë, nga Ministria e Brendshme te Ministria e Drejtësisë.....	31

Vendim i KM
nr.213, datë 12.4.2006

Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të 15 000 m²
sipërfaqe trualli dhe të objekteve të rezervave të shtetit “Agjencia
Kavajë”, nga Ministria e Brendshme Ministrisë së Shëndetësisë,
dhe transferimin në pronësi të bashkisë së Kavajës të 49 844 m²
sipërfaqe trualli dhe të objekteve të kësaj agjencie 32

VENDIM
Nr.157, datë 15.3.2006

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË REFORMËS RREGULLATORE,
NË FUNKSION TË PËRMIRËSIMIT TË KLIMËS SË BIZNESIT**

Në mbështetje të pikave 1 e 2 të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimit të reformës rregullatore në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Vendimi nr.561, datë 1.8.2003 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të veprimit për heqjen e pengesave administrative në fushën e investimeve”, shfuqizohet.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

HYRJE

Kuadri ligjor ekzistues që prek aktivitetin e biznesit rezulton me cilësi të ulët duke ndikuar negativisht në tërheqjen e investitorëve të huaj dhe duke dekurajuar investimet vendase. Kjo është konvertuar në kosto të lartë për biznesin për t’u përshtatur me dhe respektuar kuadrin ligjor ekzistues. Kuadri rregullator jo cilësor ka nxitur një shkallë të lartë informaliteti në ekonominë shqiptare. Njëkohësisht iniciativat e ndërmarra kanë qenë të fragmentuara, me mungesë koordinimi ndërministror, si dhe mungesë e kapaciteteve të mjaftueshme për zbatimin dhe monitorimin e tyre.

Duke vlerësuar që zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe social i vendit po ndikohej negativisht nga kuadri rregullator në tërësi dhe ai për biznesin në veçanti, Qeveria Shqiptare përcaktoi si një ndër reformat e saj prioritare përmirësimin e ambientit rregullator për biznesin. Kjo reformë ka si objektiv themelor krijimin e një sistemi funksional dhe të qëndrueshëm për zhvillimin dhe menaxhimin e vazhdueshëm të reformës rregullatore, monitorimit sistematik të të gjithë komponentëve të saj përcaktimin e masave të reja të nevojshme në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit

Ky plan veprimi përcakton një program gjithë përfshirës dhe dinamik për reformën rregullatore në Shqipëri. Ai adreson jo vetëm nevojat urgjente për harmonizimin dhe thjeshtësimin e kuadrit rregullator të sektorëve të rëndësishëm, por gjithashtu iniciacionin punën për krijimin e institucioneve dhe procedurave që garantojnë një ambient miqësor, transparent dhe eficient për biznesin.

Ky plan veprimi shënon fillimin e iniciativave të reja për hartimin dhe aplikimin e parimeve të cilësisë rregullatore, të qeverisjes së mirë në Shqipëri, si dhe do të garantojë krijimin e mekanizmave që kuadri i ri rregullator duhet të respektojë për të qenë në përputhje me këto parime.

Plani i veprimit përcakton katër drejtimet kryesore ku do të përqendrohet reforma rregullatore në Shqipëri.

1. Zhvillimin e sistemit të menaxhimit të reformës rregullatore;
2. Përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues nëpërmjet heqjes së pengesave të panevojshme administrative për biznesin;

3. Përmirësimin e cilësisë së kuadrit të ri rregullator;

4. Monitorimin dhe vlerësimin sistematik të reformës rregullatore.

Këto drejtime janë organizuar në këtë plan veprimi në i) masa afat-prillra dhe ii) objektivat afatgjatë.

Plani i veprimit do të krijojë sinergjinë e nevojshme midis shumë projekteve të nisura tashmë apo atyre që janë planifikuar të fillojnë së shpejti me donatorë të ndryshëm, si Banka Botërore, USAID, Komisioni European, SECO etj.

PLANI I VEPRIMIT PËR REFORMËN RREGULLATORE NË FUNKSION TË PËRMIRËSIMIT TË KLIMËS SË BIZNESIT

Lidhja 1: Masat afat-Prill

Problemi i identifikuar	Rekomandimi	Masa e parashikuar	Afati i zbatimit	Institucioni përgjegjës	Kosto Financiare njerëzore	Financua nga	Komente
ZHVILLIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË REFORMËS RREGULLATORE							
a) Mungesa e një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e reformës rregullatore në Shqipëri	1. Krijimi i strukturës institucionale gjithëpërfshirëse për të përmirësuar ambientin rregullator të biznesit në Shqipëri	1. Përcaktimi i mekanizmit të koordinimit, raportimit, informimit, monitorimit midis Task Forcës, sekretariatit, grupeve teknike	Prill 2006	METE, Sekretariati	–	–	Këto masa do të arrihen në bashkëpunim me ekspertë e FIAS
		2. Hartimi dhe miratimi në Task Forcë i formateve standard për raportimin e statusit të reformës për të gjitha nivelet e strukturës përgjegjëse të reformës rregullatore	Prill 2006				
		3. Hartimi dhe miratimi i parimeve të qeverisjes së mirë	Shtator-tetor 2006				
		4. Fuqizimi i strukturës përgjegjëse në METE për reformës rregullatore me staf	Shtator-tetor 2006	Task Forcë METE	7 specialistë	Buxheti i Shtetit	Kriteret e specialistëve do të hartohet në përputhje me aktivitetet e reformës, në bashkëpunim me FIAS
	Rritja e kapaciteteve dhe e ndërgjegjësimit për reformën rregullatore	1. Ndërmarrja e një serie me workshop dhe seminare për përfaqësues nga sektori publik dhe privat për të dhënë informacionin e nevojshëm për aktivitetet	1-2 aktivitete në 2 muajt e parë, pas miratimit të planit të veprimit dhe 2 të tjerë pas 6 muajsh	Në bashkëpunim me FIAS	15.000 USD	Nga Buxheti i Shtetit dhe projekti BERIS	Aktivitetet synojnë rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbështetjes për planin e veprimit të reformës rregullatore Ndër të tjera, ato do të shërbejnë edhe për të thithur

		e reformës, si dhe të eksperiencave ndërkombëtare në këtë fushë					mendimet dhe eksperiencat e pjesëmarrësve në lidhje me reformën rregullatore.
		2. Studimi i eksperiencave më të mira në rajon në lidhje me reformën rregullatore	Tremujori IV 2006	Task Forcë METE, grupet teknike	E papërcaktuar	Projekti BERIS	Kjo masë do të konsolidohet në vitet e ardhshme edhe me vizita në vende të ndryshme të rajonit.
		3. Organizimi i tryezës me donatorë të ndryshëm për prezantimin e projektit BERIS dhe objektivave që synon reforma rregullatore dhe komponentë të tjerë të projektit për përmirësimin e klimës së biznesit	Prill-maj 2006	METE në bashkëpunim me Bankën Botërore	5.000 USD	Buxheti	Kjo masë synon mobilizimin e përpjekjeve për mbështetje donatore të këtij projekti.
	3. Garantimi i konsultimit të përhershëm me biznesin	1. Hartimi dhe miratimi i kalendarit të diskutimeve me komunitetin e biznesit të masave në kuadër të reformës rregullatore	Mars-prill 2006	METE, grupet teknike			Organizimi i takimeve me biznesin do të mbulohet nga shpenzimet e çdo institucioni.
PËRMIRËSIMI I KUADRIT LIGJOR EKZISTUES							
1. Aksesit në rregullore							
1. Mungesa e aksesit në kuadrin rregullator ekzistues nga biznesi dhe publiku i gjerë	1. Krijimin e një database qendror gjithëpërfshirës për të gjithë kuadrin rregullator në fuqi	1. Vlerësimi i aksesit në kuadrin rregullator nga biznesi dhe publiku i gjerë	Qershor-2006	METE, të gjitha ministratë në bashkëpunim me FIAS	–	–	Për këtë do të kërkohet edhe ekspertizë nga FIAS
		2. Përgatitja e propozimeve për konsolidimin dhe lehtësimin e aksesit në kuadrin rregullator	Nëntor-2006		E papërcaktuar	BERIS	
2. Regjistrimi							
a) Infrastruktura jo e përshtatshme dhe probleme organizative	1. Përmirësime afatprillra të natyrës organizative për mirëfunksionimin	1. Caktimi i 4 ose 5 gjyqtarë (nga 9 që janë sot) që të punojnë me kohë të plotë vetëm për procedurën e regjistrimit	Menjëherë	MD, Gjykata e Shkallës së I-Tiranë	–	–	Kjo masë nuk ka nevojë për ndërhyrje në ligj pasi shpërndarja e gjyqtarëve në dhoma dhe seksione bëhet sipas ligjit “Për organizimin e

	e zyrës së regjistrit tregtar						pushtetit gjyqësor”
		2. Gjetja e një ambienti më të përshtatshëm për zyrën e regjistrimit tregtar	prill 2006	Gjykata e Shkallës së I- Tiranë	-	-	Hapësirat e zyrës së regjistrimit tregtar aktualisht e lë shumë për të dëshiruar.
		3. Emërtimi i një kryetari zyre, si dhe të shtohet një sekretare	Tremujori i I 2006	MD, Gjykata e Shkallës së I- Tiranë	-	-	Kryetari do të jetë jurist.
		4. Regjistri Tregtar t’i përcjellë informacionet e duhura administratës tatimore dhe të gjitha institucioneve të tjera që aplikojnë sot regjistrimin e biznesit	qershor 2006	MD, dhe institucione të tjera të përfshira	-	-	Deri tani është finalizuar puna për marrëdhëniet e dy nga institucionet që lidhen me regjistrimin e biznesit (Regjistri tregtar dhe administrata tatimore).
		5. Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të regjistrimit tregtar	qershor 2006	MD	-	-	
		1. Njehsimi i tarifës së regjistrimit të bizneseve për të huaj me ato vendas	Realizuar	MD, METE	-	-	
	2. Trajtimi i pabarabartë për vendasit dhe të huajt	2. Njehsimi i tarifës së shërbimeve noteriale për të huaj me ato vendas	prill 2006	MD	-	-	
b) Shërbim i painformatizuar	1. Finalizimi i informacionit të të dhënave për të gjitha shoqëritë tregtare të regjistruara deri më sot, si dhe azhurnimi i tij i vazhdueshëm	1. Përzgjedhja e kompanisë që do të merret me hedhjen e të dhënave	prill 2006	MD, METE	-	-	Është seleksionuar kompania që do të mund të realizojë informatizimin
		2. Finalizimi i informatizimit të regjistrimit tregtar	qershor 2006	MD	-	-	Kjo do të arrihet në bashkëpunim me kompaninë e përzgjedhur
		3. Evidentimi i saktë i të gjitha depozitimeve të kompanive		MD	-	-	
		4. Hedhja e të gjitha depozitimeve		MD	-	-	
		5. Vlerësimi i mekanizmit që do të	2006	MD, Gjykata e Shkallës së I-	E papërcaktuar		

		sjellë zgjidhjen me depozitimet e reja		Tiranë			
c) Sistemi i centralizuar i regjistrimit të biznesit	1. Rishikimi i modelit të regjistrimit të biznesit	Vlerësimi i mundësisë për krijimin e një institucioni të pavarur për regjistrimin e biznesit	dhjetor 2006	METE, MD	E papërcaktuar	USAID	Kjo masë do të bëhet në bashkëpunim me projektin e propozuar për krijimin e One-stop-shop për regjistrimin e biznesit.
B. Licencimi¹							
a) Mungesa e metodologjisë së vlerësimit për sistemin e licencimit	1. Zhvillimi i metodologjisë së vlerësimit të sistemit të licencimit	1. Miratimi i metodologjisë për rishikimin e sistemit të licencimit	prill 2006	METE në bashkëpunim me ministrinë e linjës	–	–	Për këtë masë do të bashkëpunohet ngushtësisht me ekspertët e FIAS për të vlerësuar Guillotinë apo instrumente të tjera të mundshme
		2. Miratimi i listës për kryerjen e analizave sektoriale	prill 2006				
b) Mungesa e analizave sektoriale dhe e vlerësimeve përkatëse	1. Rishikimi i të gjitha licencave, lejeve, autorizimeve, etj. sipas institucioneve që ofrojnë shërbimin	1. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	prill 2006	METE, grupi i licencimit në bashkëpunim me ministrinë e linjës	–	–	Në bërjen e analizave sektoriale do të konsiderohen: - Rekomandimet e raportit të vetëvlerësimit; - Rekomandimet e studimit të barrierave jotarifore; - Tipat e instrumenteve rregullatore, FIAS
		2. Ministria e Shëndetësisë	prill 2006				
		3. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	maj 2006				
		4. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	qershor 2006				
		5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	korrik 2006				
		6. Ministria e brendshme	shtator 2006				
		7. Ministria e Arsimit dhe Shkencës	tetor 2006				
		8. Institucione të varësisë	nëntor-dhjetor 2006				
		2. Miratimi i	1. Miratimi i analizave	Çdo tre muaj	Task Forcë, METE	–	–

¹ Sistemi i licencimit përfshin licencat, lejet autorizimet dhe çdo lloj tjetër dokumenti administrativ i lëshuar nga administrata publike për biznesin

	listës për kryerjen e analizave sektoriale	sektoriale nga Task Forcë					
		2. Hartimi i urdhit të Kryeministrit për çdo raport		METE			
	3. Prezantimi i rezultateve tek grupet e interesit	Për secilën nga analizat sektoriale, në përfundim të saj do të bëhet prezantimi tek biznesi	Në përputhje me afatet e përcaktuara për analizat sektoriale	METE, Grupi i licencimit			Agjenda e takimeve është në varësi të
c) Licencat e ushtrimit të aktivitetit/qeverisja lokale	1. Rishikimi i tërësisë së licencave dhe çdo akti administrativ të qeverisë lokale	1. Krijimi i skedarit të plotë me të gjitha lejet dhe licencat e lëshuara nga institucionet lokale	qershor 2006	METE, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme	-	-	
		2. Takimi me grupet e interesit të lidhura me këtë problematikë	nëntor-dhjetor 2006				
		3. Diskutimi me përfaqësues të pushtetit lokal për kompetencat e reja të mundshme për t'u transferuar nga pushteti qendror tek vendor					
d) Mundësia për informacion	1. Krijimi i One-stop-shop për licencimin	1. Përcaktimi i hapave për hartimin e aktit të thjeshtëzimit administrativ	prill 2006	METE, në bashkëpunim me FORMEZ	E papërcaktuar	BERIS, SECO	Për këtë mendohet të fillohet me sektorë që mbulon METE për të provuar efektivitetin e këtij instrumenti
		2. Krijimi i One-stop-shop pilot për disa sektorë specifikë, sipas modelit italian	dhjetor 2006				
C. Problemet doganore							
a) Vlerësimi doganor b) Arbitraritet, mungesë transparence, vlerë referuese e përcaktuar në mënyrë klientelistë, verifikim i cunguar dhe abuzive të faturave të dyshuara		1. Miratimi i një udhëzimi për mënyrën e përcaktimit të vlerës doganore	prill 2006	DPD	-	-	
		2. Objektivizimi i burimeve të përcaktimit të vlerës					
		3. Riorganizimi i strukturave dhe funksioneve të njësisë të					

		specializuara të kontrolleve a posteriori					
c) Kontrolli fizik i mallrave Kontrolle të dubluara pa krITER		1. Miratimi i një platforme kontrolli bazuar në analizën e riskut	prill 2006	DPD	-	-	
d) Fenomeni i ryshfetit Krijimi i mitit mbi domosdoshmërinë e ekzistencës së tij Rroga të ulëta dhe funksionim i keq i skenave të bonuseve		1. Të propagandohen masa ndëshkuese për rastet e konstatimit	prill 2006	DPD	-	-	
		2. Përmirësimi i sistemit të pagave dhe bonuseve në funksion të rritjes së shkallës së motivimit dhe përgjegjshmërisë					
e) Informatizimi	Shtirja e sistemit të instaluar në të gjithë territorin	1. instalimi i sistemit në pikat doganore të mbetura jashtë tij	qershor 2006	DPD			
Menaxhimi i dokumentacionit shkresor është primitiv		2. Krijimi i një modeli progresivisht digjital aplikimi, shqyrtimi kërkesash dhe autorizimi të shërbimeve			-	-	
f. Dublime të strukturave e agjencive bashkëvepruese	Harmonizimi i strukturave në pikat e kalimit të kufirit	1. Prezantimi i një strukture të vetme me kompetenca të plota për ushtrimin e të gjitha llojeve të kontrolleve	qershor 2006	DPD	-	-	
		2. Zgjerimi i strukturave të laboratorit doganor					
g) Informalitet dhe debi të prapambetura	Përmirësime në lidhje me debitë e krijuara në vite të parikuperueshme	1. Ristrukturimi i debive dhe mundësisë së shlyerjes së tyre	prill 2006	DPD	-	-	Do të shikohet mundësia e vendosjes së afateve dhe faljes së kamatëvonesave
h) Mbrojtja e së drejtës së markës tregtare	Asnjë strukturë nuk ka qenë funksionuese në këtë drejtim	1. Krijimi i një strukture të specializuar për luftën kundër piraterisë dhe mashtrimit Bashkëveprim me strukturat ndërkombëtare	prill 2006	DPD	-	-	
i) Penalitetet dhe drejta e apelit		1. Propozimi i ndryshimeve ligjore dhe	prill 2006	DPD	-	-	

		përgatitja e akteve nënligjore					
		2. Krijimi i komitetit të apelimeve					
j) Tranzitimi i mallrave	Përmirësime në drejtim të kërkesave të konventave ndërkombëtare të transportit rrugor	1. Miratimi i udhëzimeve për njohjen dhe zbatimin praktik të konventave 2. Lehtësimi i procedurave të kontrollit dhe tarifave për tranzitimet ndërkombëtare	prill 2006	DPD	-	-	TIR Carnet, etj.
k) Bashkëpunimi me autoritetet e tjera kufitare	Shmangia e dublimeve dhe abuzimeve në punën e shërbimeve policore	1. Shndërrimi i MoU nga një mekanizëm formal në një mekanizëm bashkëveprues real	prill 2006	DPD	-	-	
l) Rregullat e origjinës dhe marrëveshjet e tregtisë së lirë	Përmirësimi i monitorimit të MLT-ve	1. Ndërtimi i një moduli sipas eksperiencës maqedonase për administrimin në platformë WEB të kuotave MTL	prill 2006	DPD	-	-	
		2. Rritja e rolit të laboratorit doganor për zbatimin e rregullave të origjinës sipas standardeve ndërkombëtare			-	-	
D. Problemet tatimore							
a) Legjislacioni aktual ka boshllëqe, kontradikta të brendshme dhe është ndryshuar shpesh	1. Përmirësimi i cilësisë së legjislacionit fiskal, me qëllim shmangien e ndryshimit të tij të shpeshtë	1. Rishikimi i ligjit për procedurat tatimore 2. Rishikimi i ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar 3. Rishikimi i ligjit për tatimin mbi të ardhurat	dhjetor 2006	DPT	50 mijë EURO	DFID+ DPT	Rishikimet synojnë: Konsolidimi i ligjeve pasi kanë ndryshime te shumat në vite; Eliminimi i boshllëqeve të evidentuara (p.sh. boshllëqet në masat shtrënguese, metodat e vlerësimit, etj); Përafrimin e këtyre ligjeve me legjislacionin e BE;

							Eliminimi i kontradiktave midis vetë ligjeve fiskale dhe këtyre të fundit me pjesën tjetër të legjislacionit civil (p.sh: lidhur me penalitet, apelimet, etj.) Draftet paraprake janë përgatitur me asistencën e DFID dhe janë akoma në finalizim brenda DPT
b) Administrimi tatimor me gjithë përmirësimet nga viti në vit mbetet akoma problematik	1. Përmirësimi i administrimit të tatimeve duke përmirësuar marrëdhëniet me tatimpaguesit dhe duke vendosur procedura dhe formularë më të thjeshtë	1. Rishikimi i metodave alternative në përcaktimin e detyrimeve	Dhjetor 2006	DPD	Pa kosto		
		2. Lidhja e marrëveshjeve të përbashkëta me shoqatat e specializuara të biznesit	Në vazhdim				Kjo masë synon rritjen e frymës së bashkëpunimit dhe mirëkuptimit me tatimpaguesit
		3. Konsultimi me grupet e interesit dhe biznesin në përgjithësi	Prill-qershor 2006				Kjo masë synon: (i) rritjen e transparencës, (ii) garantimin e përcaktimit të procedurave korrekte, transparente dhe të qarta
		4. Thjeshtimi i procedurave të deklarimit dhe pagesës së kontributeve e të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhe bëhet e aplikueshme nga qershor 2006	6/mujori i parë 2006				Masa synon shkrirjen e dy deklaratave aktuale në një të vetme
c) Shqetësime lidhur me llogaritjen e kësteve paraprake të tatimit mbi fitimin	1. Vendosija e fleksibilitetit në llogaritjen e parapagimit të tatimit mbi fitimin për të arritur që fitimet aktuale të tatimpaguesve në	1. Rishikimi i formulës aktuale të llogaritjes së kësteve paraprake të tatimit mbi fitimin, në kuadër të rishkrimit të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, pas konsultimit me shoqatat e biznesit	dhjetor 2006	DPT	Pa kosto		Kjo do të fillojë zbatimin në vitin fiskal 2007

	një periudhë të caktuar të reflektohen më saktë	2. Rishikimi i udhëzimit përkatës për të reflektuar ndryshimin e mësipërm ligjor	dhjetor 2006				Ky ndryshim do të synojë edhe përcaktimin e mënyrës për monitorimin e zbatimit të formulës së re nga administrata tatimore nëpër degët e tatimeve
d) Vështirësi në rimbursimin e TVSH-së	1. Garantimi i rimbursimit të TVSH në përputhje me dispozitat ligjore, kryesisht për eksportuesit	1. Lëshimi i një urdhri të drejtorit të përgjithshëm për rikonfirmimin e vendimit për rimbursimet korrente	prill 2006	DPT	Pa kosto		100% e eksportuesve të klasifikuar me risk 0, do të rimbursohen menjëherë pas paraqitjes së kërkesës për rimbursimi.
		2. Përgatitja e raportimit mujor mbi rimbursimet	Çdo muaj				Raporti do të përmbajë kërkesat e paraqitura për rimbursime, kërkesat e miratuara dhe rimbursimet e kryera
		3. Paraqitja tek përfaqësuesi i FMN dhe në MF i raportit mbi rimbursimet	Çdo 3/mujor				
		4. Lehtësimi i procedurave të kontrollit të kërkesave për rimbursim	Në proces				Kjo do të arrihet në kontrollet me zgjedhje bazuar në analizën e riskut
		5. Përfundimi i pagimit të rimbursimeve të prapambetura nga viti 2004 e më parë	3/mujori i parë 2006				
		6. Përfshirja e të dhënave për rimbursimet në MIS (në kuadrin e rishikimit të tij)	3/mujori i 2006				
		7. Heqja e detyrimit të eksportuesve të klasifikuar me nivel të ulët risku për të mos paraqitur konfirmimin e vendit pritës të mallit për eksportet e kryera	3/mujori i parë 2006				
e) Problematika për informimin dhe edukimin e bizneseve	1. Përmirësimi i konsultimit publik me tatimpaguesit	1. Përmirësimi i manualit të punës për shërbimet ndaj tatimpaguesve	dhjetor 2006	DPT	50 mijë EURO	USAID	
		2. Rishikimi i të drejtave dhe detyrimeve të	dhjetor 2006				Ndryshimet e menduara: Të drejtat/detyrimet e

		tatimpaguesve					tatimpaguesve në rastin e një kontrolli fiskal, lidhur me apelimet, etj.
		3. Përgatitja dhe publikimi/fletëpalosjeje për të drejtat e tatimpaguesve	6/mujori II 2006				
		4. Përgatitja dhe publikimi i produkteve të reja për publikun e gjerë për ndryshimet ligjore fiskale	Tremujori I 2007				
		5. Sigurimi i ambienteve të përshtatshme për zyrat e shërbimit ndaj tatimpaguesve dhe vënia në efikasitet të plotë e këtyre zyrave	nëntor 2006				
		6. Përmirësimi i shërbimit të vazhdueshëm në linjën e telefonit jeshil, duke përcaktuar saktë dhe procedurat e menaxhimit të informacionit	6/mujori I 2006				
		7. Trajnimi i inspektorëve tatimorë që merren me shërbimin ndaj tatimpaguesve	gjatë vitit				Kjo masë do të realizohet në përputhje me planin e veçantë të trajnimeve
f) Metodat e kontrollit janë jo të përshtatshme dhe seleksionimi për kontroll jo bashkëkohor	1. Përmirësimi i kontrollit të tatimpaguesve me synimin për të bërë atë më pragmatik dhe cilësor	1. Përgatitja e programit automatik të seleksionimit për kontroll sipas analizës së riskut, testimi dhe implementimi i tij në degët e tatimeve	tetor 2006	DPT	30 mijë EURO	CAM-A	
		2. Rishikimi i manualit të kontrollit me synim krijimin e fleksibilitetit, që bazuar në analizën e	Tremujori IV 2006				

		riskut të kalohet në kontrole me zgjedhje për probleme të veçanta					
		3. Hartimi i programeve te kontrollit	Vazhdimisht				Kontrollet do parashikohen te Prillra dhe për probleme të veçanta me risk të lartë
		4. Organizimi i kontroleve te prillra për vlerësimin e qarkullimit të tatimpaguesve të kategorive të ndryshme	6/ majori 2006				Kjo masë synon kryesisht tatimpaguesit potencial për t'u kaluar në tatimpagues të regjistruar në TVSH
g) Administrata tatimore nuk është sa duhet efiçente në kryerjen e funksioneve të saj bazë	1. Përmirësimi i mbledhjes se detyrimeve tatimore	1. Trajnimi i inspektorëve të kontrollit tatimor sipas një programi te veçantë	gjatë vitit	DPT	Pa kosto		Kjo masë do të realizohet në përputhje me planin e veçantë të trajnimeve
		2. Rishikimi dhe përmirësimi i treguesve për matjen e performancës së menaxhimit të administratës tatimore	6/ majori 2006				
		3. Përcaktimi i objektivave konkrete për administratën tatimore në përgjithësi për respektimin e procedurave që çojnë në rritjen e vetëdeklarimit të tatimeve	6/ majori 2006				
h) Efiçense e ulët në kontrole	1. Përcaktimi i treguesve të performancës së inspektimeve	1. Monitorimi i arritjes së objektivave të përcaktuara lidhur me treguesit e performancës së menaxhimit	Çdo muaj	DPT	Pa kosto		
		2. Rishikimi dhe përmirësimi i treguesve për matjen e	6/ majori 2006				

		performancës së kontrolleve fiskale					
		3. Vendosja e objektivave konkrete për çdo degë të tatimeve dhe për administratën tatimore në nivel qendror, lidhur me kontrollet tatimore	6/ majori 2006				
E. Toka dhe ndërtimi							
a) Procedura burokratike për lejen e ndërtimit	1. Lehtësimi i pengesave burokratike për marrjen e lejes së ndërtimit	1. Ripunimi i rregullores së urbanistikës (RrU)	MPPTT (ISPU)	prill 2006			Ripunimi i rregullores së urbanistikës (RrU) është në proces nga ISPU
		2. Përgatitja e akteve nënligjore të ligjit në fuqi	MPPTT (ISPU)	prill 2006			Hartimi i udhëzimeve për këtë qëllim do të realizohet nga MPPTT dhe ISPU
		3. Ripunimi i rregullores së KRRTRSH	MPPTT (ISPU)	prill 2006			Ripunimi i rregullores së KRRTRSH është në proces nga MPPTT dhe ISPU
		4. Hartimi i kuadrit të ri ligjor për planifikimin e territorit	MPPTT	prill 2007			Hartimi i kuadrit të ri ligjor për planifikimin e territorit do të drejtohet nga MPPTT dhe do të përfshijë konsulencë të huaj dhe debate me grupet e interesit
		5. Hartimi i strategjisë kombëtare të planifikimit të territorit	MPPTT	prill 2007			Hartimi i kuadrit të ri ligjor për planifikimin e territorit do të drejtohet nga MPPTT dhe do të përfshijë konsulencë të huaj dhe debate me grupet e interesit
		6. Ristrukturimi i ISPU	MPPTT (ISPU)				
b) probleme me tokën	1. Lehtësimi i pengesave burokratike të lidhura me problemet e pronësisë mbi tokën dhe me transparencën e	1. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese dhe planifikimi afatmesëm dhe afatgjatë i veprimtarisë së SRPP	ZQRPP	qershor 2006			
		2. Përcaktimi i procedurave të kontrollit të regjistrimit fillestar	ZQRPP	dhjetor 2006			Përcaktimi i standardeve të kontrollit të cilësisë që duhet të ushtrrojë SRPP ndaj

	çështjeve të përfundojë, si dhe krijimi i tregut të pronave të paluajtshme						produktit që hyn në zyrat e regjistrimit, procedura të cilat mungojnë
		3. Përfundimi i regjistrimit fillestar në Korçë, Vlorë dhe Mat dhe në 2 zona kadastrale të qytetit të Tiranës	ZVRPP e rretheve përkatës/OSBE	dhjetor 2006			
		4. Fillimi i strategjisë së automatizimit	ZQRPP	dhjetor 2006			
		5. Modelimi i funksionimit të zyrave të regjistrimit	ZQRPP/ZVRPP në rrethet përkatëse	dhjetor 2006			
		6. Përcaktimi i standardeve të shkëmbimit të informacionit me përdoruesit e SRPP	ZQRPP	dhjetor 2006			
		7. Përmirësimi i shërbimit ndaj përdoruesve të SRPP	ZQRPP/ZVRPP	dhjetor 2006			
		8. Përmirësimet ligjore nëpërmjet të cilave rregullohet veprimtaria e SRPP	ZQRPP	dhjetor 2006			
		9. Përcaktimi i procedurave të azhurnimit të informacionit	ZRPP	dhjetor 2006			
F. Inspektimi							
a) Vëzhgimi në koordinimin e punës së inspektorateve të ndryshme	Unifikimi i inspektorateve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit	Ngritja e autoritetit shtetëror të ushqimit	prill 2007	METE, MBUMK, MSH	5 milionë EURO	CARDS Qeveria italiane	Ky autoritet do të përfshijë të gjitha inspektoratet që merren me kontrollin e sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve dhe të bimëve
b) Mbivendosje ose boshllëk në kontrolle si dhe inspektimi i të njëjtit subjekt në të njëjtën kohë nga disa inspektorate		Shfuqizimi i ligjit nr.7941, datë 31.5.1995 "Për ushqimin" dhe hartimi i ligjit të ri për ushqimin	qershor 2006	MBUMK	–	–	Kontrolli i sigurisë së produkteve ushqimore në gjithë zinxhirin e prodhimit, ruajtja dhe tregtimi i ngarkohet "Autoritetit Shtetëror të ushqimit"

c) Pasaktësi në lidhje me atributet e shtetit për sigurinë apo cilësinë e produkteve në treg		1. Ngritja e qendrës së referencës për sigurinë ushqimore dhe shëndetin e kafshëve	dhjetor 2006	MBUMK	-	-	Kjo masë do të shoqërohet me shkrirjen e Institutit të Kërkimeve të Ushqimit, Instituti i Kërkimeve Veterinare kthehet në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Shëndetit të Kafshëve
		2. Amendimi i disa neneve të ligjit nr.9308, datë 4.11.2004 “Për shërbimin dhe inspektoratin veterinar”			-	-	
d) Nivel i ulët shërbimi dhe kontrolli nga laboratorët ushqimorë dhe veterinar e.	Privatizimi i laboratorëve rajonalë dhe mbyllje e disa laboratorëve në rrethe	Hartim i një strategjie për privatizimin, konsolidimin dhe akreditimin e këtyre laboratorëve	dhjetor 2006	MBUMK në bashkëpunim me donatorët	-	-	
f) Dokumentacionin e tepërt në inspektim karantinor të produkteve ushqimore me bazë bimore	Hartim i një modeli të ri më të thjeshtuar të dokumentit të kontrollit	Hartim i rregullores përkatëse dhe modelit të ri të dokumentit	qershor 2006	MBUMK	-	-	
g) Kërkesa të pa nevojshme në dokumentacionin për materialin mbjellës të importuar apo të prodhuar në vend	Përmirësime në hartimin e modelit të dokumentit të kontrollit në regjistrin që duhet të mbajë subjekti importues dhe prodhues	Hartim i rregullores përkatëse dhe modelit të ri të dokumentit	qershor 2006	MBUMK	-	-	
h) Mostrimi bëhet nga persona apo trupa jo kompetente dhe të pa certifikuar nga organet përkatëse	Të gjithë personat dhe trupat që merren me mostrimin e produkteve për analiza të ndryshme të	Të bëhet pajisja me certifikatë e nevojshme të të gjithë personave dhe trupave që merren me mostrim	qershor 2006	METE, DPS	-	-	

	pajisen me certifikatë përkatëse						
i) Detyrim i pa nevojshëm për mostrimin e artikujve jo ushqimorë në doganë dhe përplasje funksionesh nga institucionet përgjegjëse	Amendimi i aspektit ligjor në këtë fushë duke reduktuar artikujt që nuk përbëjnë rrezik për jetën, shëndetin dhe ambientin	Rishikimi i VKM nr.646, datë 12.12.2002 “Për miratimin e standardeve dhe kushteve teknike të projektimit....”, i ndryshuar	prill 2006	METE	–	–	
	Krijimi i Inspektoratit të Industrisë	Rishikimi i kuadrit ligjor ekzistues dhe hartimi i ligjit të konsoliduar për krijimin e Inspektoratit të Industrisë	prill 2006	METE	–	–	Ky Inspektorat do të ketë në përbërje inspektoratin e enëve nën presion, Inspektoratin e naftës dhe gazit dhe Inspektorati i pajisjeve elektrike
j) Mungesa në strukturat që merren me vlerësimin e konformitetit	Zbatimi i ligjit nr.9097, datë 3.7.2003 “Për vlerësimin e konformitetit” si dhe përgatitja e akteve nënligjore për të rregulluar këtë fushë	Të gjitha ministrinë (me strukturat e standardeve dhe rregullave teknike në vartësi) të realizojë zbatimin dhe përshtatjen e legjisllacionit në fushën e vlerësimit të konformitetit si dhe të ngrenë strukturat përkatëse	2006	Ministrinë përkatëse DPS, DA	–	–	
k) Përafrimi i legjisllacionit të shëndetit publik me atë të BE	Përmirësime ligjore	Ngritja e komitetit të shëndetit publik në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë	dhjetor 2006	MSH	–	–	Amendime në ligjin nr.7643, datë 2.12.1992 “Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror” dhe përfshirja e koncepteve të reja të shëndetit publik
l) Vështirësi në zbatimin e detyrave në shëndetin oral	Riorganizimi i strukturës së inspektoratit shtetëror stomatologjik	Përgatitja e akteve nënligjore	2006-2007	MSH	–	–	
m) Disa vështirësi në zbatimin e ligjshmërisë së	Amendimi i ligjit nr.9323, datë 25.11.2004 “Për	Rritja e sigurisë për barnat që importohen dhe saktësime të			–	–	Ky ndryshim do të prekë pjesën që lidhet me regjistrimin e barnave dhe

barnave	barnat...” si dhe hartimi i disa akteve nënligjore në fushën e inspektimit farmaceutik	kundërvajtjeve administrative në fushën e barnave					kundërvajtjet administrative si dhe
G. Ankimimi administrativ							
a) Probleme me procedurat e ankimit administrativ		Identifikimi i të gjitha akteve ligjore që parashikojnë procedura të ankimit administrativ si dhe të problematikës së tyre	prill 2006	MD, në bashkëpunim me M. e linjës			
b) Probleme me Kodin e Procedurave Administrative		1. Harmonizimi i procedurave të ankimit administrativ, në përputhje me parimet e përgjithshme të Kodit të Procedurave Administrative dhe propozimet konkrete për ndryshimet e legjislativës në fuqi	prill 2006	MD			
		2. Krijimi i një gjykate administrative pilot në Tiranë dhe krijimi i seksioneve administrative në rrethet gjyqësore					
		Rishikimi tërësor si i procedurës administrative ashtu edhe i procedurave gjyqësore të lidhura me gjykimet administrative	qershor 2007	MD			Kjo masë synon unifikimin e afateve të ankimit, shkallëve të ankimit, mënyrës së ankimit, etj.
PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË KUADRIT TË RI RREGULLATOR							
a) Mungesa e mekanizmave dhe instrumenteve për garantimin e cilësisë së kuadrit të ri					E papërcaktuar	Zbatimi i RIA mbështetet nga projekti i BERIS	RIA është një term i përdorur për të përshkruar procesin e analizimit sistematik të impaktit të kuadrit rregullator RIA përdoret në shumë vende

rregullator							të OECD dhe vendeve në tranzicion për të përmirësuar të kuptuarit e impaktit social dhe ekonomik të kuadrit ligjor. Ai është i njohur gjerësisht si një mekanizëm i rëndësishëm që mund të kontribuojë në përmirësimin e klimës së biznesit dhe të nxisë një kuadër rregullator efektiv dhe eficient
	1.Zhvillimi i sistemit të vlerësimit të impaktit rregullator RIA, (Regulatory Impact Analyses)	1. Rishikimi i praktikave aktuale për koordinimin dhe analizën e propozimeve rregullatore dhe vlerësimi i efektivitetit të tyre	qershor 2006	METE, në bashkëpunim me të gjithë aktorët e tjerë			Për këtë do të përgatitet një raport për Task Forcën
		2. 1-2 workshope për të prezantuar koncepte bazë dhe rationale të RIA dhe mënyrën se si RIA funksionon në praktikë	shtator-dhjetor 2006	METE, në bashkëpunim me FIAS			
		3. Përgatitja e rekomandimeve konkrete për Task Forcën për opsionet e ofruara nga RIA	tetor 2006	METE, në bashkëpunim me të gjithë aktorët e tjerë			
		4. Përgatitja e hapave të nevojshme për strategjinë përfundimtare të RIA për t'u adoptuar nga qeveris në vitin në vijim	dhjetor 2006				
	2. Ngritja e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit për RIA-n	1. Përgatitja dhe publikimi i manualeve për përfaqësuesit e administratës në lidhje me përgatitjet për RIA	dhjetor 2006	METE, në bashkëpunim me FIAS	E papërcaktuar	BERIS dhe buxheti	
		2.Ngritja e kapaciteteve të sekretariatit të	Tremujori i IV 2006				

		reformës rregullatore në lidhje me RIA-n					
MONITORIMI DHE VLERËSIMI I REFORMËS RREGULLATORE							
A) Mungesa e vlerësimit sistematik të impaktit të reformës	1. Krijimi i sistemit të monitorimit	1. përcaktimi i treguesve të suksesit të reformës rregullatore për vitin e parë të zbatimit	Qershor 2006	METE, në bashkëpunim me të aktorët e tjerë	–	–	Kjo masë do të konsultohet edhe me FIAS
		2. takime me grupet e interesit për secilën nga fushat e planit të veprimit	Nëntor-dhjetor 2006	METE dhe të gjithë grupet teknike sipas fushave	E papërcaktuar	Buxheti	
		3. Konsolidimi i sistemit të monitorim-vlerësimit			–	–	Mekanizmat e raportimit janë pjesë e (a/1 st/1.)
	2. Vlerësimi i impaktit për vitin e parë të zbatimit	1. Vlerësimi i impaktit të reformës për vitin e parë të zbatimit dhe përgatitja e raportit përmbledhës	Prill 2007		25 000 USD	Projekti BERIS, buxheti	Kjo masë do të konsultohet edhe me FIAS
		2. Organizimi i konferencës për prezantimin e rezultateve të vitit të parë	Prill 2007		8 000 USD		
		3. Përgatitja e rekomandimeve për amendimin e planit të veprimit	Prill 2007				Konferencë me donatorët, grupet e interesit shoqërorë civile, biznesin, etj.

OBJEKTIVAT AFATGJATË NË KUADËR TË REFORMËS RREGULLATORE NË FUNKSION TË PËRMIRËSIMIT TË KLIMËS SË BIZNESIT

1. Reforma rregullatore në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit orientohet nga objektivat afatgjatë, të cilat synojnë krijimin e një ambienti transparent, të parashikueshëm dhe miqësor për biznesin dhe qëndrueshmëri në cilësinë e kuadrit rregullator për biznesin.

2. Reforma rregullatore mbështetet me ekspertizë nga Banka Botërore në kuadër të projektit “Reforma për përmirësimin e klimës së biznesit dhe të forcimit institucional (BERIS). Qeveria Shqiptare dhe Banka Botërore do të organizojnë një konferencë donatorësh për të mobilizuar të gjithë mbështetjen dhe asistencën e nevojshme.

Kjo reformë do të synojë: Zhvillimin e sistemit të menaxhimit të reformës rregullatore, me objektivin e krijimit të sistemit të nevojshëm që do të garantojë qëndrueshmëri në zhvillimin dhe zbatimin e reformës rregullatore. Për këtë do të punohet në drejtim të hartimit të një strategjie bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse për të përmirësuar ambientin rregullator të biznesit në Shqipëri. Drejtimet kryesore janë:

1. Konsolidimi i strukturës së krijuar në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës si struktura përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të të gjitha hapave të reformës, këshillimit dhe promovimin e mëtejshëm të saj. Kjo strukturë do të jetë përgjegjëse për: i) koordinimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të masave afatshkurtra të reformës rregullatore; ii) do të drejtojë punën për krijimin e sistemit të menaxhimit të reformës rregullatore për të garantuar një cilësi të lartë të kuadrit të ri rregullator që ndikon te biznesi.

2. Krijimi i kuadrit institucional të domosdoshëm për drejtimin dhe zbatimin e reformës rregullatore. Për këtë synohet hartimi dhe miratimi i parimeve të qeverisjes së mirë: koordinimit midis aktorëve të reformës, përgjegjshmërisë, përcaktimit të përgjegjësive të çdo aktori, të mekanizmave transparente të raportimit, informimit dhe prezantimit të rezultateve të reformës etj. Zbatimi i parimeve të qeverisjes së mirë do të garantojë që të gjitha iniciativat e ndërmarra në kuadër të reformës rregullatore të japin efektin pozitiv të parashikuar.

3. Hartimi dhe zbatimi i parimeve për praktikën e mira rregullatore, mbështetur në eksperiencat më të mira ndërkombëtare. Për këtë Qeveria Shqiptare do të konsiderojë parimet për cilësinë rregullatore në përputhje me parimet e cilësisë rregullatore të OECD: përgjegjshmëria, transparenca, konsistenca, objektiviteti, konsultimi etj.

4. Ngritja e kapaciteteve të struktura, që merren me reformën rregullatore dhe rritja e ndërgjegjësimit të ministrive, enteve rregullatore, biznesit dhe të gjithë aktorëve të tjerë të përfshirë për reformën rregullatore. Ky objektivi do të realizohet nëpërmjet: (i) organizimit të tryezave të përbashkëta brenda vendit më të gjithë aktorët, studimit të eksperiencave të vendeve të tjera, etj. (ii) krijimit të network-ut të nevojshëm në të gjitha ministrinë për zhvillimet e sektorit privat dhe reformës rregullatore.

5. Garantimi i konsultimeve periodike me komunitetin e biznesit dhe me grupet e interesit për të siguruar transparencë gjatë gjithë procesit të hartimit të politikave që prekin ambientin rregullator të biznesit.

Përveç kalendarit periodik të takimeve me biznesin qeveria është duke transformuar Këshillin Konsultativ të Biznesit, që është i krijuar që në vitin 2000, i cili do të shërbejë edhe si Këshilli Permanent Konsultativ me Biznesin për reformën rregullatore.

6. Përgatitja e Strategjisë/Policy/Note për reformën rregullatore për t’u miratuar nga Qeveria. Kjo strategji do të përcaktojë në një dokument të vetëm prioritet, objektivat, kërkesat dhe organizimet e nevojshme, përgjegjësitë për politikën rregullatore. Kjo do të arrihet pas studimit të praktikave dhe eksperiencave më të mira ndërkombëtare.

Përmirësimi i kuadrit ligjor ekzistues, me synim heqjen e pengesave të panevojshme dhe thjeshtimin e tërësisë së kuadrit rregullator që ndikon tek biznesi. Drejtimet kryesore janë:

1. Krijimi i lehtësirave për akses në rregulloret ekzistuese. Kjo do të synojë në një periudhë afatgjatë krijimin e një database qendror gjithëpërfshirës për të gjithë kuadrin rregullator në fuqi.

Kjo do të ndihmojë në procesin e thjeshtësimit që do të ndërmerret në kuadrin ekzistues rregullator në 7 fushat e përfshira në këtë plan veprimi.

2. Eliminimi i barrierave rregullatore të panevojshme për tregtinë dhe investimet nëpërmjet një procesi rregullator të vazhdueshëm për të arritur forcimin e efikasitetit ekonomik dhe rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare.

3. Konsolidimi dhe rishikimi i të gjithë legjislacionit që ndikon tek biznesi duke synuar krijimin e regjistrimit zyrtar elektronik të të gjithë kuadrin ligjor që ndikon tek biznesi dhe bërja e tij publike.

4. Thjeshtësimit i pengesave administrative në fushat: regjistrimi i biznesit, sistemi i licencimit, problemet doganore, problemet tatimore, problemet e tokës dhe ndërtimit, inspektimi dhe ankimi administrativ, me një objektiv afatgjatë. Objektivat e qeverisë për këto fusha në kuadër të reformës rregullatore synojnë:

i) Për regjistrimin e biznesit, synohet përmirësimi i cilësisë së shërbimit dhe efikasitetit gjatë ofrimit të këtij shërbimi si dhe reduktimi i korrupsionit gjatë regjistrimit të biznesit. Kjo do të arrihet nëpërmjet krijimit të një modeli tërësisht të ri i cili do të realizojë regjistrimin e biznesit në një herë të vetme.

Në një periudhë trevjeçare do të bëhet funksionale Qendra Kombëtare e Biznesit e cila do të shërbejë si one-stop-shop për regjistrimin e biznesit. I gjithë aktiviteti për këtë fushë do të ndiqet nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe do të monitorohet në vijimësi në kuadër të mekanizmave përkatës të reformës rregullatore.

Këto masa do të realizojnë reduktimin e ditëve të regjistrimit nga 47 ditë në 1 ditë pas tri vjetësh dhe reduktimin e % së biznesit që paguan ryshfet gjatë regjistrimit nga 19.1% në nivelet minimale të mundshme.

ii) Për sistemin e licencimit, synohet në thjeshtësimin dhe harmonizimin e procedurave të licencimit në të gjithë sektorët duke përdorur në mënyrë të harmonizuar parimet e qeverisjes së mirë dhe të eksperiencave të tilla si Guillotina, thjeshtësimi administrativ, parimi i autodeklarimit dhe autocertifikimit etj.

Sistemi i licencimit përfshin tërësinë e licencave, lejeve, autorizimeve dhe çdo akt tjetër administrativ i lëshuar nga (i) organet e qeverisjes qendrore, (ii) qeverisja lokale dhe (iii) entet e tjera rregullatore. Gjatë 2006 do të arrihet kryerja e analizave sektoriale për shërbimet e ofruara nga qeverisja qendrore dhe azhurnimi i të gjitha shërbimeve të ofruara nga qeverisja vendore.

Njëkohësisht Qeveria Shqiptare do të synojë dhënien e shërbimit për biznesin sipas eksperiencave të One-Stop-Shop duke vlerësuar eksperiencat e OECD, Formez, etj. Në vitin 2006 synohet që të eksperimentohet kjo eksperiencë në një sektor të ndjeshëm për sigurinë e jetës, shëndetit apo ambientit.

iii) Në fushën e doganave, synohet që dogana shqiptare si një institucion publik fleksibël, transparent, efektiv dhe i besueshëm të jetë e orientuar në drejtim të eksperiencave më të mira të vendeve të BE, të mbrojtë shoqërinë nga dëmet e shkaktuara nga trafikimi ndërkombëtar ilegal, si dhe të krijojë kushte të favorshme për zhvillimin e biznesit.

Ajo angazhohet ndër të tjera për të (i) garantuar sigurinë e tregut dhe shoqërisë nëpërmjet aplikimit të një mbikëqyrjeje efikente dhe zhvillimit të bashkëpunimit vendas dhe të huaj, (ii) garantuar mbledhjen e të ardhurave nga taksat që administrohen nga dogana, (iii) krijuar kushte të favorshme për zhvillimin e biznesit nëpërmjet zhvillimit të metodave moderne të punës dhe krijimit të një ambienti elektronik doganor.

Aktivitetet prioritare janë: (i) mbrojtja e tregut dhe shoqërisë si dhe administrimi i taksave, (ii) marrëdhëniet me ambientet doganore, (iii) zhvillimet organizative.

iii) Në fushën e tatimeve, synohet rritja e pajtueshmërisë së tatimpaguesve me sistemin tatimor për të maksimizuar mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, duke respektuar me rigorozitet kuadrin ligjor dhe pa cenuar të drejtat e tatimpaguesve.

Realizimi i këtyre objektivave do të bëhet i mundur nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të një cilësie të lartë për tatimpaguesit, përmirësimi të performancës së administratës tatimore, reduktimit të praktikave korruptive brenda saj, rritjes së efikasitetit së kontrolleve tatimore të bazuara në

analizën e riskut, zgjerimit të sistemit informatik të integruar dhe përmirësimit të legjislacionit tatimor duke plotësuar çdo boshllëk dhe shmangur çdo kontradiktë, si dhe duke e përafëruar atë me legjislacionin fiskal të Bashkimit Europian.

iv) Në fushën e tokës dhe ndërtimit, synohet një harmonizim më i mirë midis reformës së tokës, monitoruara në mënyrë të vazhdueshme nga Task Forca dhe të gjitha aktiviteteve të tjera ligjore dhe institucionale.

Iniciativat afatgjata do të arrijnë krijimin e tregut të pasurive të paluajtshme dhe finalizimin e regjistrimit të tyre në shkallë vendi. Paralelisht me këtë do të hartohet Strategjia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, e cila në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet vendore do të mundësojë hartimin e planeve rregulluese në shkallë vendi.

v) Në fushën e inspektimit, synohet ngritja dhe bërja funksionale e strukturës së mbikëqyrjes së tregut, e cila do të përfshijë të gjitha strukturat inspektuese dhe do të harmonizojë procedurat dhe metodologjinë e inspektimit, duke ruajtur specifikat sipas fushave. Metodologjia kryesore që do të përdoret për inspektimin është analiza e riskut pa anashkaluar çdo praktikë tjetër ndërkombëtare në këtë fushë. Studimi i IFC “Rishikimi i praktikave ndërkombëtare të reformës në inspektime”, do të shërbejë si guidë për aktivitetet e mëtejshme.

Iniciativat për inspektimin do të mbështeten në ndryshimin e parimit të inspektimit nga para-kontroll në kontroll në treg. Në periudhën afatshkurtër do të adresohen inspektimet e mbuluara nga MBUMK,MSH,METE,DPD,DPT, duke arritur krijimin e inspektorateve të vetme si për industrinë ashtu edhe për ushqimin.

vii) Në fushën e ankimit administrativ, synohet që në një periudhë afatgjatë të krijohet një gjykatë e vetme administrative. Për periudhën afatshkurtër synohet harmonizimi i procedurave të ankimit administrativ në të gjitha shërbimet që prekin biznesin dhe krijimi i gjykatës administrative pranë qytetit të Tiranës.

Përmirësimi i cilësisë së kuadrit të ri ligjor, duke synuar futjen dhe zbatimin e instrumenteve të reja të cilat do të garantojnë cilësinë e kuadrit të ri rregullator. Drejtimet kryesore janë:

1. Zhvillimi i sistemit të vlerësimit të impaktit rregullator (RIA, Regulatory Impact Analyzes) për të garantuar cilësinë e kuadrit të ri ligjor. Për këtë do të hartohet Strategjia e Qeverisë për aplikimin e RIA. RIA do të aplikohet në një numër të caktuar rregulloresh përpara se sa të transformohet në një mekanizëm i detyrueshëm për të gjitha institucionet që hartojnë kuadër rregullator me ndikim tek biznesi.

Brenda vitit 2006 do të vlerësohen praktikat e zbatuara në vend dhe do të hartohen opsionet që ofron RIA si dhe do sensibilizohen të gjitha aktorët që duhet ta zbatojnë për përfitimet dhe kostot e kësaj praktike.

2. Zhvillimi i një sistemi për planifikimin në kohë të ligjeve, rregulloreve dhe ndryshimeve përkatëse duke garantuar koordinimin horizontal midis institucioneve të Qeverisë dhe prezantimin në kohë të të gjitha iniciativave ligjore tek publiku i gjerë përpara miratimit.

3. Përmirësimi i mekanizmave të konsultimit publik për të mundësuar përfshirjen e të gjitha rekomandimeve të arsyeshme në kohë në draftet e ligjeve të reja që hartohen. Ky objektivi synon më shumë se sa komunitetin e biznesit.

4. Hartimin e rregulloreve dhe politikave ekonomike në të gjithë sektorët për të stimuluar konkurrencën e ndershme dhe për të eliminuar deformimet e tregut nga kuadri rregullator.

Monitorimi dhe vlerësimi sistematik i reformës rregullatore, duke synuar krijimin e një sistemi bashkëkohor me një përfaqje sistematike për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të impaktit të reformës rregullatore. Drejtimet kryesore janë:

1. Monitorimi i vazhdueshëm i reformës rregullaore mbi bazën e raporteve të masave të zbatuar të përgatitura nga aktorët e reformës rregullatore dhe anketimeve nga biznesi.

2. Hartimi i mekanizmave të monitorimit të reformës rregullatore duke përfshirë edhe zbatimin edhe të RIA-s.

3. Ripërsëritja e vetëvlerësimit nga Qeveria për procedurat administrative për të vlerësuar rezultate e reformës dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimet e mëtejshme. Ky vetëvlerësim do të përfshijë anketimin e biznesit dhe anketimin e institucioneve shtetërore.

4. Amendimi dhe përmirësimi i planit të veprimit në funksion të përfundimeve të vetëvlerësimit dhe rekomandimeve të dhëna në të.

VENDIM
Nr.158, datë 15.3.2006

**PËR LEJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË RRUGËVE TË PËRDORË
PROCEDURAT E PROKURIMIT TË BANKËS BOTËRORE, PËR HARTIMIN E
PROJEKTIT TË DETAJUAR TË RRUGËS RRËSHEN- KALIMASH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 9464, datë 28.12.2005 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të përdorë procedurat e prokurimit të Bankës Botërore “Zgjedhja dhe punësimi i konsulentëve të huamarrësve të Bankës Botërore, publikuar në maj të vitit 2004, duke përdorur metodën e analizës së cilësisë dhe kostos (QCBS), për hartimin e projektit të detajuar të rrugës Rrëshen-Kalimash.

2. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i vitit 2006, zëri “Studime-projekte”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.162, datë 21.3.2006

**PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE, PËRFAQËSUES TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, NË
KËSHILLIN MBIKËQYRËS TË AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË KREDIVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e anëtarëve, përfaqësues të Këshillit të Ministrave, në Këshillin Mbikëqyrës të Agjencisë së Trajtimit të Kredive, si më poshtë vijon:

- | | |
|------------------------|------------|
| - Znj. Flora Musta | financiere |
| - Znj. Gentiana Dorëzi | juriste |
| - Znj. Hekuran Vladi | financier. |

2. Anëtarët e caktuar në pikën 1 të këtij vendimi, e ushtrojnë funksionin deri në përfundim të afatit të veprimtarisë së Agjencisë së Trajtimit të Kredive, sipas nenit 23 të ligjit nr.8894, datë 14.5.2002, të ndryshuar. Në çdo rast, ata nuk mund ta ushtrojnë këtë funksion për një mandat mbi 3 vjet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.163, datë 21.3.2006

PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË “ISH-SPITALIT TË KFOR-IT, DURRËS, NGA MINISTERIA E SHËNDETËSISË TE MINISTERIA E DREJTËSISË, PËR SISTEMIMIN DHE AKOMODIMIN E KONTINGJENTIT TË TË SËMURËVE ME MJEKIM TË DETYRUAR, ME VENDIM GJYKATE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e përgjegjësisë së administrimit të “Ish-spitalit të KFOR-it, Durrës”, nga Ministria e Shëndetësisë te Ministria e Drejtësisë, për sistemimin dhe akomodimin e kontingjentit të të sëmurëve me mjekim të detyruar, me vendim gjykate, dhe kontingjentit të të paraburgosurve të qarkut të Durrësit, sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministrisë së Drejtësisë i ndalohet të ndryshojë destinacionin, ta tjetërsojë apo t’ua japë në përdorim të tretëve, pronën e përcaktuar në këtë vendim.

3. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Shëndetësisë dhe kryeregjistruesi i Zyrës së Regjistrimit të pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

GEN PLANI PLANI PIKETIMIT RRJETI RRUGOR sh 1500

FONE
MUSHE

1
PROJETI
ESECUZ.
COLABOT



PRERJA RRUGES sh 150

166 M
ASFA LTOBETONI 5cm
CARULLI RRUGOR 15cm
ZHAVOR LUMI 10cm



RROTAT E OBJEKTIT TI
REFEROHEN PIKES (B)+1.20

SHERIM

imi i objektit rriniset nga dy objektet egzistuese
a e tentionit te lartë qe shtrihet me SHTYLLA BETONI
ion Veriore te rrethimit ne distance 12 M dhe
usin A-A te objektivit ne distance 42 M.
a pika (X) (Kryqezimi i zgjatimit te faqes se rruges
gen ne plan) Distanca! e pikës (X) jane nga rrethimi
s aksis (20) 166 M. Distancat parciale te rruges te brendeshme
jane ne projekt.

UNJA ETENSIONITELARIE

VENDIM
Nr.168, datë 29.3.2006

**PËR NJOHJEN DHE PAGESËN E DETYRIMIT FINANCIAR INVESTITORIT ITALIAN
“IMMOBILIARE TOSCANA, DI BALDINI GIUSEPPE&C”, S.N.C., ORTAK NË ISH-
NDËRMARRJEN E PËRBASHKËT “ALB-IT, AGRO ADRIATIK”, HAMALLAJ, DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare” dhe të neneve 21 e 27 të ligjit 8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e aktmarrëveshjes së datës 22.1.2004, ndërmjet grupit të punës, të autorizuar me urdhrin nr.20, datë 20.1.2003 të Kryeministrit, dhe investitorit italian “Immobilare Toscana, di Baldini Giuseppe&C”, S.n.c.

2. Njohjen dhe pagesën e detyrimit financiar prej 1 300 000 (një milion e treqind mijë) eurosh për dëmin që i është shkaktuar investitorit italian “Immobilare Toscana, di Baldini Giuseppe&C”, S.n.c, ortak në ish-ndërmarrjen e përbashkët “Alb-It, Agro Adriatik”, Hamallaj, Durrës.

3. Detyrimi financiar, sipas aktmarrëveshjes së datës 22.1.2004, të paguhet në 3 këste:

- kësti i parë, 500 000 (pesëqind mijë) euro, brenda muajit qershor 2006;
- kësti i dytë, 500 000 (pesëqind mijë) euro, brenda muajit shtator 2006;
- kësti i tretë, 300 000 (treqind mijë) euro, brenda muajit dhjetor 2006.

4. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi, të përballohen nga fondit rezervë i Këshillit të Ministrave.

5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

AKTMARRËVESHJE

Lidhur në Tiranë, më 22.1.2010 ndërmjet

Grupit të punës të krijuar me urdhrin nr.20, datë 20.1.2003 të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë “Për ngritjen e grupit të punës për negocimin me investitorët italianë të shoqërisë së përbashkët italo-shqiptare “Pranvera” sh.p.k. Sukth dhe të ndërmarrjes së përbashkët “Alb-It Agro Adriatik”, Hamallaj, Durrës, përfaqësuar nga z. Thoma Miço, zëvendësministër i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, me cilësinë e kryetarit, dhe investitorit italian në ndërmarrjen e përbashkët “Alb-It Agro Adriatik”, Hamallaj, Durrës, shoqërisë “Imobiliare Toscana” S.r.l., me qendër në La Spezia, Itali, shndërruar në shoqërinë “Imobiliare Toscana di Baldini Giuseppe&C” S.n.c., me qendër në Massa, via Acquale 3, sipas vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të hartuar nga noteri Chianca Gennaro në Sarzana, më datë 12.8.1998 dhe depozituar pranë Dhomës së Tregtisë në Massa Carrara, përfaqësuar nga z. Giuseppe Baldini, me cilësinë e administratorit dhe përfaqësuesit ligjor.

Në bazë të pikave 2 dhe 3 të urdhrin nr.20, datë 20.1.2003 të Kryeministrit, pas bisedimeve të kryera palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

1. Qeveria Shqiptare njih të drejtën e pagesës së detyrimit në shumën 1.3 milion euro në formën e dëmit të shkaktuar investitorit italian “Imobiliare Toscana”, S.r.l., ortak në ndërmarrjen e përbashkët “Alb-It Agro Adriatik”, Hamallaj, Durrës përfaqësuar nga z. Giuseppe Baldini.

2. Investitori italian, me pagesën e kështit të fundit të këtij detyrimi, heq dorë nga pretendimi prej 20 milionë USD, pretendim ky i parashtruar në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICSID) pranë Bankës Botërore në Uashington, si dhe nga çdo pretendim tjetër kundër Shtetit Shqiptar për marrëdhëniet e lindura dhe të zhvilluara gjer më sot në lidhje me ndërmarrjen e përbashkët “Alb-It Agro Adriatik”, Hamallaj, Durrës.

3. Detyrimi financiar do të paguhet me tre këste, sipas skemës së mëposhtme:

- 5 00 000 euro deri më 31.3.2004;

- 5 00 000 euro deri më 31.4.2004;

- 3 00 000 euro deri më 31.5.2004.

Këstet do të derdhen pranë Bankës së Kursimeve, Tiranë, në emër të “Imobiliare Toscana di Baldini Giuseppe&C” S.n.c.

4. Në rast mospagese të njërit prej kësteve:

- marrëveshja e mësipërme bie;

- këstet e paguara janë të pakthyeshme dhe zbriten nga shuma e pretenduar prej tij në rrugë gjyqësore;

- investitori italian ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e çështjes në rrugë gjyqësore në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICSID) pranë Bankës Botërore në Uashington.

5. Brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kësaj aktmarrëveshjeje, grupi i punës do të përgatisë dhe paraqesë për miratim në Këshillin e Ministrave projektvendimin për mënyrën e shlyerjes së detyrimit.

6. Kjo aktmarrëveshje bëhet e vlefshme pas miratimit të vendimit përkatës nga ana e Qeverisë Shqiptare.

7. Kjo aktmarrëveshje hartohet në katër kopje origjinale, në gjuhët shqip dhe italisht dhe në të dy tekstet respektohen përmbajtja dhe sensi i aktmarrëveshjes. Në rast mosmarrëveshjeje, palët bien dakord që të merret për bazë teksti në gjuhën shqipe.

Pasi e lexojnë dhe e gjejnë konform interesave të tyre, palët firmosin këtë aktmarrëveshje.

Për grupin e punës

Kryetari

Thoma Miço

Për “Imobiliare Toscana”, S.n.c

Përfaqësuesi ligjor

Giuseppe Baldini

VENDIM

Nr.182, datë 21.3.2006

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË NDIHMËS SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit të Ndihmës Shtetërore me këtë përbërje:

- Z. Genc Ruli kryetar;

- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtar;

- Znj. Mimoza Vokshi anëtar;

- Z. Viktor Gumi anëtar;

- Z. Ledi Bianku anëtar.

2. Anëtarët e Komisionit të Ndhmës Shtetërore marrin shpërblim mujor në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, ndërsa kryetari në masën 7 000 (shtatë mijë) lekë.

3. Fondet për shpërblimin e kryetarit dhe të anëtarëve të përballohen nga buxheti vjetor, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

4. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.196, datë 5.4.2006

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2006, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE PËR KURIMIN E ZNJ. RUSHEM GOLEMI NË ITALI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 8 e 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrisë të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, zëri “Shpenzime për mallra e shërbime”, t’i shtohet fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh, për përballimin e pjesës së shpenzimeve për kurimin e znj. Rushem Golemi në Itali.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Pagesa të kryhet pas paraqitjes së faturave të shpenzimeve të kurimit.

4. Ngarkohet Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.203, datë 5.4.2006

PËR NDRYSHIMIN DHE KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË OBJEKTEVE REPARTI, KOMANDA, PALESTRA DHE POLIGONI, TË REPARTIT RENE, TIRANË, NGA MINISTERIA E BRENDSHME TË MINISTERIA E DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrisë të Drejtësisë dhe të Ministrisë të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekteve “Komanda e repartit Renea, Tiranë”, me sipërfaqe 450 m² dhe numër rendor 4 “Palestër e repartit Renea, Tiranë”, me sipërfaqe 760 m² e 144 m² dhe numër rendor 5, “Poligon i repartit Renea, Tiranë”, me sipërfaqe 665 m² dhe numër rendor 3, si dhe trualli i objektit “Repartit Renea, Tiranë”, me sipërfaqe 3406 m² dhe numër rendor 1, sipas formularit që i bashkëlidhet vendimit nr.250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të

pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, t’u ndryshojë përgjegjësia e administrimit dhe të kalojë nga Ministria e Brendshme te Ministria e Drejtësisë për ndërtimin e mjediseve të Gjykatës së Krimeve të Rënda.

2. Pronat me numër rendor 1, 3, 4 e 5 të hiqen nga lista e inventarit të pronave, që janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Brendshme, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Brendshëm dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.213, datë 12.4.2006

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË 15 000 M² SIPËRFAQE TRUALLI DHE TË OBJEKTEVE TË REZERVAVE TË SHTETIT “AGJENCIA KAVAJË”, NGA MINISTRIA E BRENDSHME MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË KAVAJËS TË 49 844 M² SIPËRFAQE TRUALLI DHE TË OBJEKTEVE TË KËSAJ AGJENCIE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10 e 11 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, si dhe të neneve 3, 5, e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të 15 000 m² sipërfaqe trualli dhe të disa objekteve të rezervave të shtetit “Agjencia Kavajë”, nga Ministria e Brendshme Ministrisë së Shëndetësisë. Prona kufizohet: në jug nga rruga qytet-autostradë, në lindje nga ish-SMT-ja, në perëndim nga autostrada dhe në veri nga pjesa që i transferohet në pronësi bashkisë së Kavajës.

2. Transferimin e një sipërfaqeje 49 844 m² truall dhe të objekteve të rezervave të shtetit “Agjencia Kavajë”, në pronësi të bashkisë së Kavajës, por kësaj bashkie nuk i transferohet “Magazina (depo) nr.7”, e cila ka kaluar në përgjegjësi administrimi të prefektit të qarkut të Tiranës, me vendimin nr.773, datë 19.11.2004 të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Shëndetësisë, kryetari i bashkisë së Kavajës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 4.6.2010

Doli nga shtypi më 6.6.2010

Tirazhi: 2300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja ADEL PRINT
Tiranë, 2010

Çmimi 34 lekë